

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 04 -2009
Prishtinë, më 09 shkurt 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Džezair Murati, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

Mungoi: Branisllav Grbiq.

Të pranishëm: Blerina Uka – NDI, Lejla Selimi OSBE, Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Arben Bajra – RTK, Edmond Zeqiraj – RTK, Shqipe Osmani – Bota Sot, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Astrit Krasniqi - OJQ-RKD, Driton Selmanaj - KDI, dhe Vlora Marmullakaj - EULEX.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 3 shkurtit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektstrategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009 - 2011;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Hasan Pretenit, drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit;
5. Shqyrtimi i reagimit të deputetes Suzana Novobërdaliu, kryesuese e Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
6. Të ndryshme.
 1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. Shprehu bindjen se kjo

mbështetje do të vazhdojë edhe në të ardhmen. I njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 3 shkurtit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektstrategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009 -2011

Kryetari - Në diskutimin e tij për shqyrtimin e Projektstrategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009 – 2011, shtoi se nga ajo që ka parë në këtë projektstrategji i plotëson kriteret e një plani. Ne si Komision kemi mundësi t'i japim vërejtjet dhe komentet lidhur me këtë çështje. Theksoi se kjo projektstrategji nuk është voluminoze dhe i përmban në vete edhe objektivat e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit. Në të bëhet fjalë si luftohet korrupsioni dhe përmenden edhe ligjet bazike. Për këtë pikë të rendit të ditës hapi debat.

Armend Zemaj – Nuk do të ndalem shumë rreth projektstrategjisë së luftimit të korrupsionit, sepse është paraqitur mirë në këtë plan, por vërejtja ime është, përse nuk është përfshirë në këtë plan edhe Zyra e Auditorit të Brendshëm, sepse me ligj roli i saj është forcuar.

Bajram Kosumi - Vuri në dukje se e kishte përcjellë pak a shumë strategjinë e parë të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit. Kjo është strategjia e dytë. Mendoj se është hartuar mirë, nga shumë mekanizma dhe jo vetëm nga Agjencia. Në parim e përkrah këtë projektstrategji.

Dzezair Murati - Duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi se kjo projektstrategji është hartuar mirë. Jam për një bashkëpunim të institucioneve ndërmjet vete për ta luftuar korrupsionin, sepse korrupsioni nuk është vetëm një lëshim subjektiv, por është shumë më kompleks. Në shumë shtete ka edhe telefona të hapur për qytetarë që lajmërojnë për korrupsionin. Shtoi se e përkrah këtë projektstrategji të paraqitur nga Agjencia.

Kryetari - I pyeti anëtarët e Komisionit a e përkrahin këtë projektstrategji.

Projektstrategjia e paraqitur nga Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit për periudhën 2009 - 2011 u përkrah nga Komisioni.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Hasan Pretenit, drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit

Kryetari – Duke folur për shqyrtimin e kërkesës së Hasan Pretenit, drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, tha e dini se më 14 tetor 2008 si Komision e kemi dhënë një interpretim të drejtë dhe të bazuar në Ligjin kundër korrupsionit (nenet 21.1 dhe 22), lidhur me këtë çështje. Për Këshillin e Agjencisë e kemi dhënë një interpretim, por tash kërkohet që Këshilli të ketë qasje edhe në dosje dhe shtrohet çështja e besueshmërisë për dosjet. Sipas nenit 21 të këtij ligji, Këshillit i jep të drejtë ta mbikëqyrë punën e Agjencisë, por edhe Agjencia ka të drejtë në besueshmërinë e lëndëve që procedohen në Agjenci. Lidhur me këtë çështje u hap një debat.

Ibrahim Makolli – Shtoi se në këtë rast i kemi dy çështje me dy kërkesa: njëra nga Hasan Preteni dhe tjetra nga Suzana Novobërdaliu. Pyeti: Kush ka të drejtë në këtë rast? Mendoj se AKK-ja ka rënë në kundërshtim me vetveten. Nëse Këshilli nuk ka kompetencë, pse është formuar? Në këtë rast mendoj se Suzana Novobërdaliu ka të drejtë, sepse këtë ia mundëson ligji.

Armend Zemaj - Mendon se kjo është çështje e vullnetit dhe e bindjes. Këto janë dy çështje: hetimi dhe raportimi. Në vazhdim shtroi dilemën pse drejtori dhe Këshilli nuk gjejnë gjuhë të përbashkët? Dihen detyrat dhe përgjegjësitë edhe të drejtorit, edhe të Këshillit të Agjencisë.

Bajram Kosumi - Lidhur me këtë çështje shtoi se ne si Komision duhet ta kemi një qëndrim të përbashkët. Raportet ndërmjet drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë duhet të bazohen në ligj. Këshilli nuk bën hetime, por e kontrollon punën e Agjencisë, përndryshe do të ishte i pakuptimtë ekzistimi i Agjencisë. Këshilli duhet të kërkojë raport nga drejtori i Agjencisë, por jo edhe të kërkojë t'i shikojë dosjet.

Adem Salihaj - Duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi se roli i Këshillit është ta mbikëqyrë Agjencinë. Kjo është përcaktuar me nenin 21.1 të Ligjit, që Këshillit i jep të drejtë të ketë qasje vetëm në hetimet e përfunduara. Ne si Komision e kemi dhënë interpretimin tonë dhe nuk ka nevojë të interpretohet përsëri kjo çështje.

Selvije Halimi - Shtoi se ky ligj duhet të plotësohet, sepse nga dy shkresat që i kemi marrë i kemi dy interpretime të ndryshme të dispozitave për këtë çështje. Legjislacioni duhet t'i përshtatet strategjisë së luftimit të korrupsionit. Interpretimin e tij tash e tutje do ta bëjë Gjykata Kushtetuese.

Komisioni ishte i mendimit ta përsëriste letrën e tij të 14 tetorit 2008, në të cilën citohet vetëm neni që ka të bëjë me lëndët e shqyrtuara në Agjenci.

6. Të ndryshme

Kryetari - Theksoi se si Komision do ta kemi edhe Projektligjin për hetim parlamentar. Gjithashtu duhet të përcaktohem për ligjet, zbatimin e të cilave do ta mbikëqyrë Komisioni.

Ibrahim Makolli - Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve propozoi të mbikëqyrët zbatimi i Ligjit penal për të mitur.

Ramadan Gashi – I njoftoi të pranishmit për punën që e ka bërë Nënkomisioni për të Drejtën Sendore. Shtoi se shumica e punëve do të jenë kryer dhe deri të premtën do të jenë gati.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni